



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 05/1 Prot

Datë 27.2 /2015

V E N D I M

Nr. 04 datë 27.2 .2015

Në mbështetje të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, si dhe ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”,

V Ë R E J S E:

Në zbatim të Urdhrit nr. 215 datë 01.12.2014, është ushtruar inspektim administrativ pranë kontrolluesit, “Sante Plus Group” (Qendër Estetike), me objekt: “Verifikimi i zbatimit të Urdhrit nr. 08 datë 12/03/2014 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, dhënë ndaj këtij kontrolluesi.

Kontrolluesi “Sante Plus Group” (Qendër Estetike), nëpërmjet Urdhrit nr. 08, datë 12/03/2014, të Zyrës së Komisionerit, detyrohet që:

1. Në zbatim të nenit 5/1/d të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, të shkatërrojë të dhënat personale të klientëve që nuk e frekuentojnë më qendrën estetike dhe për të cilët ka përfunduar marrja e shërbimit.

2. Në zbatim të nenit 18 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar dhe të pikës 3 të kreut II të Udhëzimit nr. 23 datë 20/11/2012 “Për përpunimin e të dhënave personale në sektorin e shëndetësisë”,

- Të bëjë informimin e subjekteve të të dhënave personale që plotësojnë “formularët e regjistrimit të klientëve”, lidhur me qëllimin, masat e sigurisë që aplikohen nga kontrolluesi, mënyrën e përpunimit, mbledhjes, ruajtjes, shkatërrimit, të drejtës për akses, si dhe korrigjim të të dhënave personale të tyre;
- Në faqen e internetit të publikojë në një rubrikë të veçantë “politikat e privatësisë” (paketë rregullash), me qëllim informimin e subjekteve të të dhënave personale, si dhe të përfshijë kushtet e kriteret që reflektojnë parimet e përpunimit të ligjshëm dhe të drejtë të të dhënave personale.

Në këtë kuadër është referuar Opinioni “Mbi Mbrojtjen e të Dhënave Personale në Faqen e Internetit të Kontrolluesve Publik dhe Privat”, publikuar në faqen zyrtare të Zyrës së Komisionerit www.idp.al.

3. Në zbatim të neneve 27 dhe 28 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, të hartojë një rregullore të brendshme lidhur me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen, sigurinë dhe konfidencialitetin e të dhënave personale.

Në këtë kuadër është referuar Rregullorja tip e cila gjendet e publikuar në faqen zyrtare të Komisionerit www.idp.al, duke ofruar edhe asistencën tonë.

Për realizimin e detyrimeve të lëna në Urdhër, u përcaktua afati kohor prej 45 (dyzet e pesë) ditësh, nga momenti i marrjes dijeni për Urdhrin.

Në zbatim të nenit 32/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, kontrolluesi mbart detyrimin për të njoftuar me shkrim pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, për përmbushjen e detyrimeve të lëna në Urdhër, duke paraqitur edhe provat përkatëse. Nga inspektimi administrativ u konstatua se një gjë e tillë nuk është realizuar.

Nga inspektimi administrativ rezultoi se, kontrolluesi “Sante Plus Group” (Qendër Estetike), ka plotësuar pjesërisht, detyrimet që mbart Urdhri nr. 08, datë 12/03/2014, i Zyrës së Komisionerit. Nga verifikimi i kryer pranë ambienteve të kontrolluesit, në prezencë të (person kontakti për mbrojtjen e të dhënave personale), u konstatua se:

- Kontrolluesi “Sante Plus Group” (Qendër Estetike), e ka realizuar detyrimin e parashikuar në pikën 1 të Urdhrit nr. 08, datë 12/03/2014 të Komisionerit, duke i shkatërruar të dhënat personale të klientëve që nuk e frekuentojnë më qendrën estetike dhe për të cilët ka përfunduar marrja e shërbimit;
- Kontrolluesi e ka realizuar detyrimin për informimin e subjekteve të të dhënave që plotësojnë “formularët e regjistrimit të klientëve”, në zbatim të nenit 18 të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar dhe të pikës 3 të kreut II të Udhëzimit nr. 23 datë 20/11/2012 “Për përpunimin e të dhënave personale në sektorin e shëndetësisë”.

Në formular është parashikuar: ““Garantojmë që të dhënat që mblidhen nëpërmjet këtij formulari do të përpunohen në përputhje me ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar dhe Udhëzimi nr. 23 datë 20/11/2012 “Për përpunimin e të dhënave personale në sektorin e shëndetësisë”. Ju në cilësinë e subjektit të të dhënave gëzoni të gjitha të drejtat e parashikuara në ligj. Sante Plus Group Shpk mbron të dhënat në ambiente të sigurta deri në përfundimin e shërbimit, më pas të dhënat shkatërrohen””;

- Kontrolluesi nuk e ka realizuar plotësisht detyrimin për parashikimin e “politikave të privatësisë” në faqen zyrtare në internet www.santeplusgroup.com. Në faqe, në rubrikën “Të drejtat e pacientëve”, parashikohet: “Ne mbrojmë të drejtat e pacientëve, të gjitha llojet e informacionit personal mbrohen me sistemet më të larta të sigurisë”;

- Kontrolluesi ka hartuar “Rregulloren e brendshme lidhur me mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”, në zbatim të pikës 3 të Urdhrit, bazuar në nenet 27 dhe 28 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar.

Përfaqësuesi i kontrolluesit () nëpërmjet Procesverbalit të inspektimit deklaroi: “Për sa i përket “politikave të privatësisë” marrim përsipër që ti plotësojmë sa më parë me qëllim që të jemi sa më në përputhje me ligjin”.

Në zbatim të neneve 93-96 të ligjit 8485 datë 12/03/1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, kontrolluesi është njoftuar (nëpërmjet shkresës nr. 05 prot, datë 05.1.2015) për të marrë pjesë në procesin e shqyrtimit administrativ më datën 19/01/2015 në ambientet e Zyrës së Komisionerit. Përfaqësuesi i kontrolluesit nuk u paraqiti në seancën dëgjimore.

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, duke vlerësuar konstatimet e bëra dhe qëndrimin e kontrolluesit, “Sante Plus Group” (Qendër Estetike), mbi zbatimin e detyrimeve të Urdhrit nr. 08 datë 12/03/2014, të miratuar prej tij, konkludon se:

- Faza e parashikuar në rubrikën “Të drejtat e pacientëve”, në faqen zyrtare në internet www.santeplusgroup.com, nuk realizon plotësisht qëllimin e nenit 18 të ligjit pasi nuk i informon subjektet e të dhënave personale dhe vizitorët e faqes, për fushën dhe qëllimin, për të cilin do të përpunohen të dhënat personale, për personin që do t’i përpunojë të dhënat, për mënyrën e përpunimit, për të drejtat që gëzojnë në bazë të ligjit, si dhe kushtet e kriteret që reflektojnë parimet e përpunimit të ligjshëm dhe të drejtë të të dhënave personale;
- Në frymën e ligjit, çdo kontrollues që përpunon të dhëna personale, pavarësisht faktit nëse përpunimi bëhet në mënyrë elektronike apo manuale, dhe pavarësisht faktit nëse mbledh apo jo të dhëna personale nëpërmjet faqes/web-sitit në internet, ka detyrimin që të publikojë në faqe/web-sitin në internet “politikave të privatësisë”, pasi kontakti paraprak i çdo subjekti të dhënash (të dhënat e të cilëve përpunohen nga kontrolluesi) ose personi tjetër, realizohet nëpërmjet faqes/web-sitit në internet. Në këtë kuadër, publikimi i “politikave të privatësisë” në faqen/web-sitin në internet përmbush më së miri qëllimin që ka neni 18 i Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar;
- Mospublikimi i “politikave të privatësisë” në faqen e internetit, privon subjektet e të dhënave personale nga e drejta për informim (në bazë të nenit 18) dhe të drejtat e parashikuara në kreun IV “Të drejtat e subjektit të të dhënave”, të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, duke mos u dhënë mundësi në ushtrimin e tyre dhe duke i cenuar rëndë ato.

Komisioneri vlerëson se mospërmbushja e pjesës së dytë të pikës 2 të Urdhrit nr. 08 datë 12/03/2014 të miratuar prej tij, e ngarkon kontrolluesin me përgjegjësi administrative, sipas nenin 39 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar.

- Kontrolluesit, që nuk përmbushin detyrimin për të informuar, të përcaktuar në nenin 18 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, bazuar në nenin 39, pika 1/b, të këtij ligji, dënohen me 10 000 deri në 300 000 lekë.

Për zgjedhjen e masës së gjobës, Komisioneri ka parasysh: faktin se shkelja e konstatuara është serioze pasi lidhet me të drejtën e subjekteve të të dhënave personale për informim si një e drejtë parësore në zbatim të ligjit, seriozitetin e zbatimit të detyrave që dalin nga Urdhri i Komisionerit, mospërmbushjen në kohë të detyrimeve, zbatimin e ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, nenin 39/2 në të cilin parashikohet

se, "Personat juridikë, për kundërvajtjet e mësipërme, dënohen me dyfishin e gjobës së përcaktuar në pikën 1 të këtij neni", faktin që kontrolluesi ka marrë masa për rikuperimin e disa prej shkeljeve të konstatuara paraprakisht.

PËR KËTO ARSYE:

Në zbatim të neneve 18, 29, 30/2, 39/1/b, 40 e 41, të ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", si dhe 107-109 të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë".

V E N D O S A:

1. Dënimin e kontrolluesit "Sante Plus Group" (Qendër Estetike) me gjobë në vlerën **30 000 (tridhjetë mijë) lekë**, për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 18 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar.
2. Gjoha arkëtohet nga kundërvajtësi në Buxhetin e Shtetit, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga komunikimi i këtij vendimi. Me kalimin e këtij afati, ky vendim kthehet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga zyra e përmbarimit.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e njoftimit.
4. Ky vendim u shpall sot më datë 27 10/2015.

